




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS

SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.394/2021

Datë: 30 nëntor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.25, nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 33 dhe 34 i Rregullores Nr. 03/2021 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Gjyqtarëve, në mbledhjen 272-të, të mbajtur më datë 30 nëntor 2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Sami Gashi, gjyqtar me mandat fillestar në Gjykatën Themelore Prizren, propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 30 nëntor 2021.

A r s y e t i m

Komisioni për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve më datë 19 nëntor 2021, i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të vendos mbi propozimin për riemërimin e gjyqtarit Sami Gashi, me mandat të përhershëm, mandati fillestar i të cilit përfundon më 21 janar 2022.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 30 nëntor 2021, pas shqyrtimit të rekomandimit të Komisionit për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, vendosi që gjyqtari Sami Gashi, të propozohet tek Presidentja e Republikës së Kosovës, për riemërim me mandat të përhershëm.



Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës;
- Z. Sami Gashi, gjyqtar në Gjykatën Themelore Prizren;
- U.d. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.